



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.1,
Korrik 2017

KRIMI NDËRKUFITAR DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL I PARANDALIMIT TË TIJ

Nikoll Rica*, Dhurata Islambejo*

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, "Albanian University", Tiranë, Shqipëri

Adresë kontakti: nikoll_rica@yahoo.com

Përmbledhje

Nëpërmjet kësaj teme synojmë të përcillet tek lexuesi informacion mbi veprat penale që mund të kryhen nëpërmjet kufirit shtetëror, veçoritë e ndjekjes penale, zbulimit, parandalimit dhe ndëshkimit të autorëve, si dhe forcimit të bashkëpunimit rajonal për parandalimin e kësaj veprimtarie.

Këto lloj krimesh janë të ndeshura me kohë në vendin tonë, kanë karakter ndërkombëtar dhe sjellin pasoja tepër të rënda për jetën e qytetarëve, stabilitetin, rendin dhe sigurinë kombëtare, por dekadën e fundit konstatohet shtimi i kësaj veprimtarie.

Me interes për lexuesin do të jetë trajtimi i konceptit mbi menaxhimin e integruar të kufirit në Ballkanin Perëndimor, si dhe analiza juridike e veprave penale që lidhen me trafikimin e lëndëve narkotike dhe mjeteve motorike, falsifikimin e dokumenteve, kalimin e paligjshëm të kufirit, dhënien ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, etj.

Aspekti i analizës juridike të ligjit material do të trajtohet i lidhur ngushtë me veprimtarinë procedurale penale, si dhe detyrat që kryen Departamenti i Policisë së Kufirit dhe Migracionit për investigimin e kësaj veprimtarie. Gjithashtu, do të trajtohet bashkëpunimi i strukturave të policisë në planin dypalësh dhe rajonal për menaxhimin e integruar të kufijve shtetërorë, me synim krijimin e një koncepti më të qartë mbi shkëmbimin e informacionit kriminal, realizimin e operacioneve të përbashkëta, si dhe sekuestrimin e mjeteve që kanë shërbyer për realizimin e veprimtarisë kriminale.

Bashkëpunimi ndërkufitar do të trajtohet i lidhur ngushtë me zhvillimin e teknologjisë dhe programet e përbashkëta që po realizohen me vendet fqinje, kryesisht në vendkalimet kufitare për kontrollin e personave dhe të mjeteve. I gjithë procesi do të studiohet në planin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Fjalë çelës: *Menaxhim i integruar i kufirit; siguria kufitare; bashkëpunim ndërkufitar; parimet dhe standardet bazë të kufirit; informacioni kriminal.*

CROSS-BORDER CRIME AND ITS PREVENTION THROUGH REGIONAL COOPERATION

Abstract

Through this subject we intend to provide the reader with information about criminal offenses that may be committed across the state border, features of the prosecution, detection, prevention and punishment of the perpetrators, as well as strengthening of regional cooperation to prevent such activity.

These types of crimes have been long encountered in our country, have international character and bring about highly serious consequences to the lives of citizens, stability, order national security and order; but over the last decade an increased such activity has been noted.

Of interest to the reader will be dealing with the concept of integrated border management in the Western Balkans and analysis of legal offenses related to the trafficking of narcotics and motor vehicles, forgery of documents, illegal border crossing, providing assistance to illegal border crossing, etc.

In terms of substantive law legal analysis it will be dealt with closely linked procedural criminal activities and tasks conducted by the Department of Border and Migration Police to investigate this activity. It will also deal with cooperation between police authorities in bilateral and regional plan for integrated management of state borders, with a view to creating a clear concept on the exchange of criminal information, conducting joint operations, as well as seizure of means served for the preparation of criminal activity.

Cross-border cooperation will be considered closely associated with the development of technology and joint programs being implemented with neighboring countries, mainly at the border control of persons and vehicles. The whole process will be studied in terms of respect for human rights and fundamental freedoms.

Keywords: *Integrated border management; border security; cross-border cooperation; basic principles and standards of the border; criminal information.*

Hyrje

Në kushtet e proceseve të integritetit dhe globalizimit evropian, gjithnjë e më shumë ka gjetur përdorim dhe po konturohet në një përkufizim më të plotë termi “krimi ndërkufitar”. Kur flasim për krim ndërkufitar, menjëherë mendja na shkon tek ato figura krimi që lidhen ngushtësisht me kufijtë shtetërorë, si: kalimet ilegale të kufirit, falsifikimi i dokumenteve të udhëtimit apo dëmtimi i shenjave kufitare.

Mirëpo, “globalizimi si proces, krahas përparësive në marrëdhëniet midis shteteve, shoqërohet edhe me fenomene negative të kriminalitetit ndërkufitar, të cilat janë bashkudhëtare të këtij procesi” (1). Krimi nuk ka nacionalitet, dhe si i tillë ai nuk ka as kufij. Në këtë kuptim, krimi ndërkufitar nuk mund të kualifikohet vetëm në kuadër të figurave që përmendëm më sipër, pasi ai lidhet edhe me fenomene të tjera kriminale, si: trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i mjeteve motorike të vjedhura, trafiku i drogës, i armëve dhe materialeve të rrezikshme (eksplozivëve, materialeve radioaktive, lëndëve helmuese dhe biologjike, si dhe i materialeve me përdorim të dyfishtë), trafiku i mallrave të akcizës, si dhe kontrabanda.

Ndërkohë, me krimin kufitar janë të lidhura edhe fenomene që në pikëpamjen juridike konsiderohen

kalime të ligjshme të kufirit. Është e drejtë e çdo qytetari të kalojë legalisht kufirin shtetëror në pikat legale të kalimit të kufirit. Por kjo e drejtë shpeshherë shfrytëzohet për të përdorur territorin e shtetit tjetër për t'u afruar dhe për të kaluar ilegalisht kufijtë e një shteti të tretë (në të shumtën e rasteve shtet anëtar i Bashkimit European). Ky kalim përdoret edhe në rastet kur persona të ndryshëm kanë kryer vepra penale dhe nga frika e zbulimit apo ndëshkimit të tyre, largohen legalisht për t'u fshehur në shtete të tjera.

Modelet europiane për sigurinë e kufirit

“Siguria e *kufijve të jashtëm* të vendeve të BE-së konsiderohet si një nga faktorët bazë të sigurisë së përgjithshme të këtyre vendeve, për një jetë normale të popujve të tyre dhe në tërësi për familjen e madhe europiane” (2). Rreziqet që sot vijnë nga jashtë, veçanërisht rreziqet e terrorizmit, krahas masave të tjera, mund të parandalohen edhe me forcimin e masave dhe të kontrollit në kufi, sidomos në kufijtë e jashtëm të BE-së, por edhe të aeroporteve ndërkombëtare dhe të porteve të tyre. Përvoja e viteve të fundit tregon se jo vetëm në vendet e BE-së, por edhe në ShBA e më gjerë, rreziqet terroriste shtohen edhe nga veprimtaritë që ushtrohen nëpërmjet kufijve. Gjithashtu, “trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i drogës, i armëve, i lëndëve me rrezikshmëri të lartë, etj., sot janë një realitet dhe këto veprimtari kriminale kryhen duke prekur kufijtë shtetërorë të vendeve përkatëse” (3). Prandaj këto vende i kushtojnë vëmendje të veçantë sigurisë së kufijve shtetërorë, veçanërisht sigurisë së kufijve të tyre të jashtëm, si dhe të aeroporteve ndërkombëtare e porteve.

Për realizimin e këtij qëllimi nuk ka një model të njëjtë të masave, por aplikohen modele të ndryshme për kontrollin dhe sigurinë e kufijve në përputhje me:

1. specifikat apo veçoritë e çdo vendi,
2. legjislacionin kombëtar të tyre,
3. marrëveshjet dhe protokollet ndërkombëtare të ratifikuara,
4. strukturat policore që funksionojnë në çdo vend,
5. sistemet e drejtësisë,
6. traditën e çdo vendi, etj.

Modelet e strukturave policore që kontrollojnë kufijtë shtetërorë të vendeve të BE-së janë të ndryshme si (4):

- në ndërtimin e tyre,
- në vartësinë që ato kanë,
- në veprimtarinë praktike.

Kështu:

- Ka disa modele ku shërbimi për kontrollin e kufijve përfshihet në Ministrinë e Brendshme, por ka një linjë të pavarur komandimi dhe kontrolli (p.sh., Finlanda dhe Estonia).
- Ka modele të përziera ku funksione të ndryshme të menaxhimit të kufirit kryhen nga organizata të ndryshme, pa pasur një shërbim të centralizuar kufiri (p.sh., Greqia).
- Ka modele ku shërbimet për kontrollin e kufirit janë në vartësi të Ministrisë së Rendit Publik dhe Policia Kufitare është nën linjën Drejtorive Rajonale të Policisë (p.sh., Kroacia e Sllovenia).

Konkluzioni: Nuk ka një model universal shërbimi për sigurinë e kufijve, por të gjitha modelet duhet të ndjekin disa standarde universale.

Nëse flasim për kontrollin e *kufijve të brendshëm* të vendeve të BE-së, ky koncept tashmë ka ndryshuar rrënjësisht, pasi qarkullimi brenda familjes europiane është krejtësisht i lirë. Por kjo nuk do të thotë që kufijtë shtetërorë të tyre janë shkrirë. Çdo shtet evropian i BE-së ka një territor dhe një sipërfaqe të caktuar që nuk ndryshon dhe që është e përcaktuar pikërisht nga kufijtë shtetërorë përkatës. Sigurisht që kjo përvojë dhe praktikë e re nuk përjashton përgjegjësitë dhe kompetencat e policive përkatëse për të ushtruar kontrolle në kufijtë dhe në territoret e tyre përkatëse, veçanërisht për të zbuluar dhe goditur migracionin e paligjshëm dhe rreziqet terroriste. Përvoja austriake e Policisë Kufitare tregon se kjo strukturë ka në përbërjen e saj një njësi speciale, të kompletuar, e cila ka kompetencë të ushtrojë kontroll në të gjithë territorin e këtij vendi për të zbuluar veprimtarinë kriminale të trafikimit dhe për të shmangur rreziqet e terrorizmit.

Koncepti i menaxhimit të integruar të kufirit në Ballkanin Perëndimor

Menaxhimi i integruar i kufirit nënkupton bashkërendimin dhe bashkëpunimin midis të gjitha autoriteteve dhe agjencive përkatëse që janë të përfshira në sigurinë kufitare, lehtësimin e tregtisë dhe bashkëpunimin rajonal, me qëllim që të krijohet një sistem efikas për menaxhimin e kufijve dhe realizimin e qëllimit të përbashkët, për të pasur kufij të hapur, të kontrolluar dhe të sigurt.

“Menaxhimi i integruar i kufijve synon të sigurojë koordinim të brendshëm dhe ndërkombëtar midis shërbimeve të ndryshme që merren me luftën kundër krimit ndërkufitar, me qëllim garantimin efikas të kufijve” (5). Kjo veprimtari do të lejojë që shtetasit të jetojnë në një zonë sigurie dhe lirie, ku ata të udhëtojnë më lirshëm dhe biznesi i tyre të mund të operojë pa pengesa përmes kufijve, si parakusht për rritje ekonomike dhe reduktim të varfërisë.

Zhvillimi i lëvizjeve ndërkufitare do të mbështesë gjithashtu zhvillimin e shumë shoqërive të hapura, me mirëkuptim dhe tolerancë për diferencat gjuhësore, fetare dhe kulturore me fqinjët. Në të njëjtën kohë, kërcënimet që kanë të bëjnë me abuzimet dhe keqtrajtimin e sistemit të menaxhimit të kufijve, si për shembull, kontrabanda dhe trafikimi i njerëzve, drogës, armëve etj., mund të përballohen më mirë, nëse autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e kalimit të kufijve shtetërore përmirësojnë shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin midis tyre.

Shtetet e Ballkanit Perëndimor (ku përfshihet edhe Shqipëria) duhet të zbatojnë rregulloret që kanë të bëjnë me menaxhimin e kufirit në mënyrë të tillë që të jenë konform *EU acquis communautaire* që mbulon kërkesat e Shengenit. Ky element shikohet si kusht për përfshirjen e tyre në marrëveshjen e BE-së, ekzistencën e kapaciteteve bazë sipas kriterëve të Kopenhagenit, si dhe krijimin e kushteve në fushën e tregtisë. Me qëllim që të arrihet kjo, ato duhet të bëjnë disa përmirësime administrative, organizative apo në burimet njerëzore, si dhe modifikime të rëndësishme të sistemeve ekzistuese të menaxhimit të kufirit.

Prandaj nuk ka rregulla strikte për të gjitha fushat e menaxhimit të integruar të kufijve, tipin e saktë të infrastrukturës në vendkalimet kufitare, numrin e nevojshëm të efektivit, sasinë apo cilësinë e pajisjeve teknike etj. Megjithatë, këto standarde kërkojnë që sistemi të jetë efektiv dhe t'i përshtatet rrezikut (6). Për më tepër, përvojat dhe praktikat më të mira të vendeve anëtare të BE-së, dhe së fundmi të vendeve të pranura apo candidate për pranim, na japin tregues të bazuar për krijimin e sistemeve të përshtatshme për menaxhimin e kufijve. Qëllimi afatgjatë është që sistemet e menaxhimit të kufirit të arrijnë një nivel të pranueshëm të standardeve të BE, për të garantuar se një ditë shërbimet e tyre kufitare kombëtare do të jenë në gjendje të marrin përsipër përgjegjësinë për kufijtë e jashtëm të BE dhe në stadin tjetër të jenë në përputhje me kërkesat e Shengenit.

Detyrat kryesore që ndërmerren në kufi kanë lidhje me personat, mjetet e transportit dhe mallrat.

Të gjitha këto përfshijnë kontrolle në vend apo parandalimin e hyrjeve të pakontrolluara me anë të kufijve tokësorë dhe detarë. Detyrat që lidhen me personat janë kontrolli i dokumenteve të udhëtimit, lejeve të drejtimit të automjeteve, dokumenteve të identitetit e vizave, dhe përfshin çështje të tilla si: kërkesat për azil dhe trajtimi i duhur i tyre, sipas traktateve dhe konventave ndërkombëtare, i personave të kapur pa dokumente etj.

Mjetet e transportit duhen kontrolluar për regjistrimin, sigurimin, standardet e sigurisë, lejet e transportit, vulat dhe personat apo mallrat e fshehur. Detyrat tipike në lidhje me mallrat (ngarkesë dhe bagazhe) janë kontrollet për sigurimin se të gjitha mallrat identifikohen dhe shpjegohet përmbajtja e tyre kur hyjnë në territorin e një vendi, në mënyrë që të sigurohet mbledhja e taksës doganore dhe kontrollet e nevojshme në lidhje me kufizimet për shkak të sigurisë publike, mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mbrojtjes së pasurisë kombëtare me vlera historike, arkeologjike apo artistike, apo mbrojtjen e pasurisë industriale dhe tregtare.

Shkeljet e mundshme në kufi dhe në vendkalimet kufitare mund të jenë të shumta, duke përfshirë trafikimin e personave, kontrabandën e mallrave, kafshëve, drogave, substancave të rrezikshme dhe armëve. Meqenëse mundësia e këtyre shkeljeve është e madhe, kërkohet një sistem kontrolli, i cili duhet të jetë edhe efektiv, edhe i shpejtë, menaxhimi i të cilit është mjaft i komplikuar.

Nga ana tjetër, rritja e turizmit dhe e tregtisë ndërkombëtare, si dhe shkëmbimet kulturore e edukative, kërkojnë kufij më të hapur. Si rezultat, autoritetet kufitare janë të detyruara të gjejnë një balancë delikate midis kontrolleve të rrepta dhe kufijve tërësisht të hapur. Sigurisht që kjo hapje duhet të jetë për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave me dokumente të rregullta dhe rreptësisht e mbyllur dhe e padepërtueshme ndaj veprimtarive kriminale që rrezikojnë stabilitetin në rajon. Trafikimi i çdo lloji emigracioni i paligjshëm dhe terrorizmi duhet të ndalohet në të gjithë rajonin, dhe sidomos në rastet e kalimit të kufirit. Dyert e mbyllura ndihmojnë për të parandaluar përhapjen e krimit jashtë vendit, për të shmangur mosdënimin e kriminelëve dhe për të zvogëluar fitimet e tyre.

Lufta kundër krimit, forcimi i institucioneve të drejtësisë e punëve të brendshme dhe zbatimi i ligjeve në përgjithësi, janë themelore për përparimin e vendit drejt integritetit evropian.

Elementet kryesore të luftës kundër krimit ndërkufitar

Katalogu i Shengenit ka përcaktuar pesë elemente të rëndësishme të luftës kundër krimit ndërkufitar, si dhe të sigurimit të kufijve nga vendet pjesëmarrëse. Ato janë:

- Informacioni,
- Kontrolli,
- Survejimi,
- Inteligjenca,
- Personeli.

Këto elemente duhet të merren domosdoshmërisht në konsideratë dhe të gjejnë zbatim të plotë në veprimtarinë e përditshme të strukturave të policisë kufitare shqiptare, por edhe të vendeve e tjera të rajonit, të cilat aspirojnë të futen në Bashkimin Europian. Përafrimi i legjislacionit dhe i praktikave të shërbimit janë procese të cilat kërkojnë jo vetëm angazhim të shumë strukturave shtetërore, por dhe një impenjim të vazhdueshëm nga punonjësit e Policisë Kufitare dhe Migracionit.

Efektiviteti i zbulimit kriminal dhe menaxhimi efikas i kufirit është i lidhur ngushtë me krijimin e disa kushteve siç janë:

1. Krijimi i një strukture funksionale të Policisë Kufitare dhe Migracionit; (7)

2. Miratimi i një baze ligjore të plotë;
3. Personel i kualifikuar;
4. Motivim i personelit;
5. Mbështetje logjistike.

Realizimi i këtyre faktorëve bën të mundur që strukturat e Policisë Kufitare dhe të Migracionit të kenë kapacitetet e duhura dhe autonominë funksionale për të përmbushur përgjegjësitë ligjore në parandalimin e krimit ndërkufitar. Analiza e veprimtarisë së këtyre strukturave tregon se vitet e fundit Policia Kufitare dhe Migracionit në Shqipëri është ngritur mbi bazën e përvojës së vendeve të BE për kontrollin e kufijve shtetërorë. Hartimi i kuadrit ligjor me ndihmën dhe konsulencën e ekspertëve të këtyre vendeve, pjesëmarrja në trajnime brenda dhe jashtë vendit ka bërë të mundur që personeli policor të ketë një vizion më të qartë për detyrat që kryen, duke synuar përafrimin me parimet dhe standardet europiane të menaxhimit të kufirit. Megjithatë, intensiteti i veprimtarisë së kundërligjshme përmes kufirit shtetëror është shtuar. Format e kalimeve ilegale të njerëzve që vijnë nga vende të treta, si dhe të mallrave, janë sofistikuar. Prandaj, kërkohet një performancë dhe organizim i ri i shërbimit të policisë kufitare dhe të migracionit në përshtatje me këto ndryshime.

Bashkëpunimi, faktor kyç i parandalimit të krimit ndërkufitar

Bashkëpunimi përbën një ndër faktorët më të rëndësishëm për të arritur sukses në luftën kundër krimit ndërkufitar dhe migracionit të paligjshëm. Elementet e bashkëpunimit duhet të fokusohen në tri shtylla kryesore, të cilat janë:

1. Bashkëpunimi brenda agjencisë, i cili ka të bëjë me vendosjen e një bashkëpunimi të brendshëm dhe të efektshëm *për veprimet operationale dhe* për menaxhimin e informacionit e burimeve brenda një shërbimi përgjegjës, ndërmjet niveleve vendore, rajonale dhe qendrore (bashkëpunimi vertikal); dhe ndërmjet njësive të ndryshme të niveleve të njëjta (bashkëpunimi horizontal). Në radhë të parë ky bashkëpunim duhet të reflektohet tek strukturat e Policisë së Shtetit, i cili përfshin jo vetëm bashkëpunimin brenda strukturave të Policisë Kufitare dhe Migracionit, por dhe me strukturat e Policisë Kriminale, të Policisë së Rendit e Sigurisë Publike, dhe ato të Qarkullimit Rrugor (8). Me qëllim forcimin e Sistemit të Sigurisë Kufitare, të gjitha autoritetet e përfshira në çështjet kufitare duhet të forcojnë bashkëpunimin në nivel vendor (operacional) rajonal dhe qendror. Bashkëpunimi me strukturat që kanë ndikim në kufi, ka të bëjë kryesisht me doganat, shërbimin fito-sanitar dhe shërbimin veterinar. Ky bashkëpunim mbështetet në rregullore dhe memorandume bashkëpunimi dhe mirëkuptimi të miratuara nga titullarët e institucioneve përkatëse. Këto akte me fuqi ligjore nuk kanë synim të dublojnë punën ndërmjet institucioneve, por të përcaktojnë sa më saktë që të jetë e mundur detyrat dhe përgjegjësitë e secilit institucion, si dhe mënyrat e shkëmbimit reciprok të informacioneve dhe të veprimeve të përbashkëta për të përmbushur me sukses misionin dhe detyrat nga secili.
2. Bashkëpunimi ndërmjet agjencive përmban bashkëpunimin në nivel lokal, në nivel rajonal dhe në nivel qendror ndërmjet ministrive ose organizmave shtetërore me detyra të ndryshme në lidhje me menaxhimin kufitar. Ky bashkëpunim përfshin operatione, veprime dhe analizë risku të përbashkët, shkëmbim informacioni dhe përdorim të përbashkët të pajisjeve. Këtu përfshihet bashkëpunimi ndërmjet Policisë Kufitare dhe Migracionit, Shërbimit Doganor, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Shërbimit Antiepidemik Sanitar dhe të agjencive të tjera të përfshira jo direkt në menaxhimin e integruar të kufirit, siç janë: Shërbimi Konsullor, Roja bregdetare, Qendra Ndërinstitucionale Operationale Detare (QNOD), Administrata Detare (Drejtoria e

Përgjithshme Detare, Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale, Kapitaneritë e Porteve, Kontrolli Shtetëror Portual, Kontrolli Shtetëror i Flamurit, Regjistri i Mjeteve Lundruese të RSH, Regjistri i Detarëve të RSH, Agjencia Kombëtare e Trafikut Ajror (ANTA) dhe SHISH.

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar bazohet: në *bashkëpunimin* në nivel ndërmjet përfaqësuesve të agjencive kufitare në të dyja anët e kufirit; ndërmjet shteteve fqinje (p.sh., nga kufizimi i kalimit dhe menaxhimi kufitar, deri në organizimin e patrullave dhe zyrave të përbashkëta të kontaktit; dhe në nivel shumëkombësh për t'iu përqasur më mirë fushave të përbashkëta të punës, të tilla si krimi ndërkufitar, emigrimi i parregullt, trafikimi i qenieve njerëzore, terrorizmi dhe kontrabandimi i mallrave. Ky bashkëpunim rregullohet nën një frymë miqësore dhe mirëbesimi reciprok ndërmjet policive kufitare të vendeve fqinje, duke u mbështetur në memorandume mirëkuptimi dhe marrëveshjeje bashkëpunimi. Pa bashkëpunim efektiv ndërkufitar nuk mund të ketë rezultat lufta ndaj krimit ndërkufitar. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi realizohet shkëmbimi i informacioneve reciproke për:

- drejtimet dhe aktivitetet ilegale ndërkufitare,
- persona konkretë në të dy anët e kufirit që dyshohet apo kryejnë aktivitet kriminal,
- vendndodhjen e personave që kanë kryer krime në vendin e tyre dhe fshihen në territorin e vendit fqinj,
- hyrjet e daljet e personave nga të dy anët e kufirit në përgjithësi dhe për personat me precedent kriminal,
- mënyrën e organizimit të shërbimit dhe mjetet e përdorura për survejimin e kufirit,
- alternimin e shërbimeve me qëllim shfrytëzimin maksimal të efektshmërisë së personelit dhe teknologjisë,
- shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve të instaluar nga secila palë.

Bashkëpunimi ndërkufitar konsiderohet në shkallën më të lartë kur arrihet në kryerjen e operacioneve të përbashkëta, si dhe në hapjen e Pikave të Kalimit Kufitar të përbashkëta. Kjo e fundit kërkon nënshkrimin e një akti normativ në nivel qeveritar apo parlamentar.

Punonjësit e Policisë Kufitare dhe Migracionit, me qëllim që të përdorin informacionin si profilizues efektiv, duhet:

- Të njohin specimenet e pasaportave, duke i poseduar secili nga kontrollorët që shërbejnë në PKK.
- Të njohin dokumentet e udhëtimit për çdo vend nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme.
- Të njohin format dhe metodat e falsifikimit të dokumenteve të udhëtimit, secili të posedojë modele të falsifikimeve të përdorura më parë.
- Të njohë rrugët që ndjek trafikimi ilegal. Ky informacion duhet të përgatitet nga shefat përkatës.

Punonjësit e Policisë Kufitare dhe Migracionit i përcjellin shërbimit Doganor, Policisë Kriminale dhe Policisë së Rëndit e Sigurisë Publike informacionet që kanë të bëjnë me:

- Intensitetin e lëvizjes së njerëzve në PKK dhe listat e tyre.
- Dokumentet e falsifikuara që konstatohen në PKK.
- Llojet e trafikeve dhe aktiviteteve të tjera kriminale ndërkufitare.
- Numrin dhe gjeneralitetet e personave me tendenca për krime ndërkufitare.

Punonjësit e Policisë Kufitare dhe Migracionit marrin prej shërbimeve të Doganës dhe Policisë Kriminale e asaj të Rendit e Sigurisë Publike informacionet për:

- Llojet e aktiviteteve kriminale që lidhen me kufirin, si: trafiku i drogës, i armëve, falsifikimi i dokumenteve të udhëtimit, trafiku i qenieve njerëzore, etj.
- Rrugët dhe format e përdorura për realizimin e aktiviteteve ilegale kriminale që njeh dogana.
- Nivelin e kriminalitetit në përgjithësi.
- Veprat penale që ndodhin në thellësi, si: vrasje, grabitje, etj., pasojat e të cilave japin efekte në problemet e kufirit.

Në pikat e kalimit kufitar shkëmbimi i informacionit realizohet ndërmjet Policisë Kufitare dhe Migracionit, Shërbimit Doganor, Shërbimit Fito-Sanitar, Shërbimit Veterinar, Inspektorëve të Policisë Kriminale dhe Policisë së Rendit e Sigurisë Publike, si dhe homologëve të shtetit fqinj. Kjo realizohet nëpërmjet takimeve periodike, takimeve sa herë ndodhin ngjarje që lidhen me detyrat për kufirin, si dhe me analiza të përbashkëta.

Disa nga masat e mundshme për përmirësimin e besueshmërisë së kontrollorëve në pikat e kalimit kufitar janë:

- Mbajtja në evidencë dhe kryerja e analizave në çdo rast të kthimit të personave nga vendet e tjera.
- Ndërrimi në kohë të ndryshme e në befasi të vendeve të punës së kontrollorëve.
- Qarkullimi nëpër pikat e kalimit kufitar të kontrollorëve.

Është e domosdoshme që operatorët të cilët do të punojnë me regjistrat të jenë të limituar dhe të zgjedhur.

Për të rritur efektivitetin e punës së kontrollorëve në pikat e kalimit kufitar, si dhe për t'i përdorur ata si profilizues efektivë të riskut duhet:

- a. Të trajnohen sipas një plani vjetor të miratuar.
- b. Të trajnohen në grupe të vogla në detyrë kur merren informacione të reja.
- c. Të kryhen trajnime specifike për probleme që kanë ndodhur diku tjetër, por që pritet të ndodhin dhe këtu.

Në pikat e kalimit kufitar për qëllime operationale, menaxheriale dhe analitike duhet të mblidhet informacion për:

- Fluksin e lëvizjeve të pasagjerëve nga vendi ynë në drejtim të vendit fqinj dhe anasjelltas.
- Listat e pasagjerëve.
- Personat e kapur.
- Dokumentet e falsifikuara të kapura.
- Listat e personave që tentojnë të kalojnë në mënyrë të parregullt.
- Listat e personave që lëvizin me dokumente të rregullta, por për të cilët ka informacion nga sektorët e tjerë së kryejnë aktivitete ilegale.
- Listën e personave që tentojnë të kalojnë para të padeklaruara për llogari të tyre apo të personave të tjerë.

Efektiviteti operacional i survejimit të kufirit jeshil shpesh matet nëpërmjet:

- Numrit të personave të kapur në të dy anët e kufirit.
- Me ndryshimin e drejtimeve të lëvizjes së personave që tentojnë të kalojnë kufirin.

Lëvizjet pa kriter në nivelet e komandantëve dhe kontrollorëve dëmtojnë punën, e në mënyrë të veçantë, luftën efektive ndaj krimit ndërkufitar. Ata mund të lëvizin për motivet e mëposhtme:

- a. Kur vërtetohet se janë të paaftë.
- b. Kur vërtetohet ose bindemi në dyshimet tona se janë të korruptuar.
- c. Për nevoja qarkullimi ose ngritje në detyrë.

Ushtrimi i attributeve të Policisë Gjyqësore nga Policia Kufitare dhe Migracionit sjell përparësi në luftën kundër krimit ndërkufitar, pasi:

- Informacioni perceptohet drejtpërsëdrejti nga punonjësit e Policisë Kufitare dhe Migracionit.
- Veprohet më shpejt dhe grumbullohet evidencë me e plotë.
- Rritet koeficienti i parandalimit të aktiviteteve ilegale e kriminale në kufi.
- Sjell interesim më të lartë dhe nivel më të mirë profesional nga punonjësit e Policisë Kufitare dhe Migracionit.

Përfundime dhe rekomandime

1. Krimi ndërkufitar është i lidhur ngushtësisht me kufijtë shtetërorë. Ai nuk ka nacionalitet dhe një kufij. Me krimit ndërkufitar janë të lidhura jo vetëm kalimet e paligjshme edhe fenomene të tjera kriminale, si: trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i mjeteve motorike të vjedhura, trafiku i drogës, i armëve dhe materialeve të rrezikshme (eksplozivëve, materialeve radioaktive, lëndëve helmuese dhe biologjike, si dhe i materialeve me përdorim të dyfishtë), trafiku i mallrave të akcizës, por dhe kontrabanda.
2. Siguria e kufijve të jashtëm dhe të brendshëm konsiderohet si një nga faktorët bazë të sigurisë së përgjithshme të vendeve, për një jetë normale midis popujve. Nuk ka një model universal shërbimi për sigurinë e kufijve, por të gjitha modelet duhet të ndjekin disa standarde universale.
3. Rreziqet që u vijnë shteteve nga terrorizmi, krahmasave të tjera, duhet të parandalohen me forcimin e kontrollit në kufirin e gjelbër, kufirin blu, si dhe me forcimin e masave në aeroportet ndërkombëtare dhe portet.
4. Menaxhimi i integruar i kufirit nënkupton bashkërendim dhe bashkëpunim midis të gjitha autoriteteve dhe agjencive përkatëse që janë të përfshira në sigurinë kufitare, lehtësimin e tregtisë dhe bashkëpunimin rajonal, me qëllim që të krijohet një sistem efikas për menaxhimin e kufijve dhe realizimin e qëllimit të ***përbashkët, për të pasur kufij të hapur, të kontrolluar dhe të sigurt.***
5. Zhvillimi i lëvizjeve ndërkufitare duhet të mbështesë zhvillimin e shumë shoqërive të hapura, me mirëkuptim dhe tolerancë për diferencat gjuhësore, fetare dhe kulturore me fqinjët. Kërcënimet, abuzimet apo keqtrajtimet e sistemit të menaxhimit të kufijve, përbëjnë rrezik për marrëdhëniet midis shteteve.

6. Bashkëpunimi ndërkufitar mbetet prioriteti kryesor në luftën kundër krimit dhe migracionit të paligjshëm. Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet operacioneve të përbashkëta midis policive vendore dhe qendrore të shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Për forcimin e masave, në funksion të parandalimit dhe të goditjes së aktiviteteve të kundërligjshme që kryhen nëpërmjet kufirit shtetëror tek ne, gjithashtu rekomandojmë:

1. Zhvillimin e detajuar të analizave të riskut, e mbi bazën e tyre, riorganizimin e të gjitha shërbimeve të Policisë Kufitare në vijën e kufirit të gjelbër e blu, duke i shtrirë shërbimet, jo në mënyrë lineare, por duke i përqendruar në zonat, rajonet, rrugët apo oraret më të nxeha, e më të shfrytëzuara nga trafikantët.
2. Planizimin e shërbimit të orientuar mbi bazën e informacionit, duke mbuluar të gjithë hapësirat dhe duke kombinuar patrullimin me automjetet, vrojtimin me mjete optike, **përdorimin** e mjeteve lundruese, etj.
3. Mbajtjen nën vëzhgim me shërbime të bazave të depozitimit të lëndëve narkotike, jo vetëm në vijën e kufirit, por edhe në thellësi, si dhe ngritjen e postblloqe në rrugë dhe rajone që përbëjnë risk për trafikim të paligjshëm.
4. Ndryshimin e vendeve të shërbimit, orareve apo drejtimeve, duke planifikuar gracka dhe shërbime të fshehta në të gjithë drejtimet e mundshme, me qëllim zbulimin, parandalimin dhe kapjen e autorëve dhe mjeteve që kryejnë aktiviteti kriminal.
5. Harmonizimin dhe bashkëpunimin më të mirë të shërbimeve brenda policisë kufitare me shërbimet e tjera të Policisë së Shtetit, kryesisht asaj të policisë kriminale, rendit dhe qarkullimit rrugor.
6. Përmirësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve bashkëpunuese dhe shkëmbimit të informacionit me strukturat policore të shteteve fqinje, nëpërmjet takimeve periodike, trajnimeve, planifikimit të patrullimeve të përbashkëta, etj.

Referenca

1. *Direktiva të Këshillit të Europës*. Viti 2004. Paragrafi 83.
2. *Rregullorja e Këshillit të Europës*, 343/2003/EC (Dublin II); kapitulli i dytë, faqe 87.
3. *Manual i zbatimit të ligjit për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore*. Përgatitur nga Qendra Ndërkombëtare për zhvillimin e Politikës së Migrimin (ICMPD), Vjenë, Austri, faqe 141.
4. *Manual trajnimi për forcat e ligjit dhe anëtarët e gjyqësorit në luftë kundër migracionit dhe kontrabandimit të emigrantëve për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Programi CARDS*. Shtator 2006. Faqe 129.
5. *Rregullorja e Komisionit Europian*. 1560/2003/EC (Dublin II); faqe 17.
6. Peter BRYANT “Migracioni i parregullt, kontrabandimi dhe trafikimi i qenieve njerëzore”. Viti 2005, faqe 88.
7. Ligji nr 9861 datë 24.01.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”. Neni 6.
8. Ligji nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Neni 46.